



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2022:165542

Datë: 11.02.2025

Numri i dokumentit: 06833301

C.nr.217/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarës Valbonë Dërvodeli në çështjen juridike kontestimore të paditëses D. L. me të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Selmon Sadiku avokat në Kamenicë, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale për Arsim, me objekt kontesti pagesën e Diferencës së pagës të zvogëluar, me vlerë kontesti e pa caktuar, jashtë seancës gjyqësore, më datën 10.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses D. L. me vendbanim në Kamenicë të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Selmon Sadiku avokat në Kamenicë, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale për Arsim, me objekt kontesti pagesën e Diferencës së pagës të zvogëluar, me vlerë kontesti e pa caktuar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë me datë 05.08.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me kërkesë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

I autorizuari i paditëses me parashtrësën e datës 24.01.2025, ka dorëzuar parashtrësë në këtë gjykatë, me të cilën parashtrësë ka tërhequr padinë dhe kërkesëpadinë, në të cilën ka theksuar se, pala paditëse ka kërkuar që ta tërheq padinë dhe Kërkesëpadinë, paditësja nuk ka interes të

vazhdoj këtë procedurë kontestimore, andaj e njëjta tërheqë padinë dhe kërkesëpadinë ndaj të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale për Arsim.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditëses, ka konstatuar se kërkesa është të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së), me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”* pa shqyrtim të mëtejshëm, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:165542, 10.02.2025**

Gjyqtarja,

Valbonë Dërvodeli, d.v.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.